



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

DIPLOMACIA SHUMËPALËSHE E SHQIPËRISË NJË HISTORI NË PËRPARIM E SIPËR 1920-2020



ALBANIA 2020 SHQIPËRIA

DIPLOMACIA SHUMËPALËSHE
E SHQIPËRISË,
NJË HISTORI NË PËRPARIM E
SIPËR
1920-2020

Tiranë 2020

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Fjala përshëndetëse

Hyrje historike

- 1-** Anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, 17 dhjetor 1920.....f. 10
- 2-** Shqipëria, mbështetëse e projekteve të para evropiane 1929-1931.....f. 12
- 3-** Shqipëria në konferencat ballkanike të viteve '30-të të shek.XX.....f. 14
- 4-** Pranimi i Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, 14 dhjetor 1955.....f. 17
- 5-** Pranimi i Shqipërisë në UNESCO, 16 tetor 1958.....f. 21
- 6-** Shqipëria në aktivitetet ballkanike gjatë Luftës së Ftohtë.....f. 23
- 7-** Shqipëria në takimin e parë të MPJ-ve të të gjitha vendeve të Ballkanit, 24-26 shkurt 1988.....f. 25
- 8-** Vizita në Shqipëri e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Javier Peres de Cuelar, 11-13 maj 1990.....f. 28

- 9-** Shqipëria organizon takimin e dytë të Ministrave të Punëve të Jashtme të Ballkanit, Tiranë 24-25 tetor 1990.....f. 30
- 10-** Anëtarësimi i Shqipërisë me të drejta të plota në KSBE (sot-OSBE),19 qershor 1991.....f. 32
- 11-**Shqipëria vendos marrëdhënie diplomatike me Komunitetin Ekonomik Evropian, 20 qershor 1991.....f. 37
- 12-**Angazhimi I Shqipërisë në nismat rajonale.....f. 43
- 13-** Anëtarësimi i Shqipërisë në Këshillin e Evropës, 13 korrik 1995.....f. 50
- 14-** Pranimi i Shqipërisë në NACC, qershor 1992, dhe antarësimi i saj në NATO, 4 prill 2009.....f. 53
- 15-** Procesi i integritimit evropian të Shqipërisë.f. 59
- 16-**Shqipëria merr Kryesinë e OSBE-së, janar 2020.....f. 63



Anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve më 17 dhjetor 1920 shënon, mes tjerash, edhe fillimin e diplomacisë shumëpalëshe të saj.

Sot, pas një shekulli ngjarjesh përgjatë Mbretërisë së Zogut, pushtimit fashist italian, Luftës së Dytë Botërore, diktaturës komuniste dhe tranzicionit të vështirë demokratik, diplomacia shumëpalëshe e Shqipërisë është zgjeruar jashtëzakonisht shumë, jo vetëm nga pjesëmarrja në nisma e organizata të ndryshme (mbi 40 sosh), por edhe nga marrja e përgjegjësi të pashembullta për forcimin e paqes, sigurisë dhe demokracisë në shkallë botërore. Ky fakt tashmë ka marrë trajtë fare të dukshme:

Shqipëria është anëtare aktive e Këshillit të Evropës, aleate e vyer në NATO, partnere me kontribut të dalluar në nismat e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor e jo vetëm, shtet që negocion për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Kryesuese e Radhës e OSBE-së dhe fare pranë shërbimit, për herë të parë në historinë e saj, si anëtare jo e përhershme në Këshillin e Sigurimit, për vitin 2022-2023.

Në njëqind vjetorin e qenies së saj, pra, diplomacia shumëpalëshe e Shqipërisë qëndron në pikën kulmore të arritjeve të saj.

Arritjet e Shqipërisë në rrafshin e diplomacisë shumëpalëshe nuk janë as çështje meritash personale. Ato, para së gjithash, janë rrjedhojë e punës së pakursyer e të përbashkët të diplomatëve të krejt brezave të vyer të Shqipërisë, për të mbrojtur, përfaqësuar dhe lartësuar vlerat e saj.

Arritjet e Shqipërisë në rrafshin e diplomacisë shumëpalëshe nuk janë aspak zhvillime të rastësishme. Në të kundërt, ato janë vetëm manifestim i një pune të vazhdueshme, atdhedashurie të thellë e vizioni të qartë për rritjen e pranisë e forcimin e zërit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Arritjet e Shqipërisë në rrafshin e diplomacisë shumëpalëshe nuk mund as të vlerësohen vetëm me datat e ngjarjeve të mëdha a me çastet e zhvillimeve kulmore. Në të vërtetë, ato nuk janë asgjë tjetër, vetëm kurorëzim i punës së përditshme të të gjithë radhëve të diplomatëve të zakonshëm të diplomacisë shqiptare në një shekull.

Prandaj, në nderim e përkujtim të shërbimit të jashtëzakonshëm të diplomatëve të të gjithë brezave, që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin e diplomacisë shumëpalëshe të Shqipërisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka vendosur të publikojë këtë broshurë të ngjarjeve kryesore historike, politike dhe diplomatike të një shekulli rrugëtimi të përbashkët - Diplomacia Shumëpalëshe e Shqipërisë – Një Histori në Përparim e Sipër, 1920-2020.

Kjo përmbledhje është gjithsesi më shumë se një pasqyrë historike njëqind vjeçare e zhvillimit të diplomacisë shumëpalëshe të Shqipërisë.

Sa për kujtim e nderim, duhet të shërbejë edhe për frymëzim e reflektim. Fundja, përkundër arritjeve të pamatshme, kjo përmbledhje nuk e paraqet edhe idenë e mbylljes së qarkut të zhvillimit të historisë së diplomacisë shumëpalëshe të Shqipërisë.


Qartësisht, diplomacia shumëpalëshe e Shqipërisë është një histori gjithnjë në përparim e sipër dhe në ripërtëritje të vazhdueshme.

Kuadro të tjerë, me projekte të reja, do krijojnë kontribute shtesë në zhvillimin e mëtejshëm të diplomacisë shumëpalëshe shqiptare, që gjithsesi do të përfshihen në përmbledhjet e dekadave apo shekujve vijues.

Lexim të këndshëm.

Gent Cakaj

Ministër në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme



7

Hyrje historike

Më 28 nëntor 1912, në Kuvendin Kombëtar të mbledhur në Vlorë, shqiptarët shpallën pavarësinë e tyre nga Perandoria Osmane, nën një qeveri të përkohëshme. Kryeministri dhe Ministri i parë i Jashtëm i *Qeverisë së Përkohëshme* të Shqipërisë së pavarur ishte Ismail Qemali.

Më 29 korrik 1913, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Fuqitë e Mëdha njohën shtetin e pavarur shqiptar dhe përcaktuan kufijtë e tij politik më 29 korrik 1913 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Me konsensus, ato vendosën që Shqipëria e pavarur të qeverisej nga princi gjerman Wilhelm of Wied në cilësinë e "*Princit të Shqipërisë Vidi I*". Deri në mbërritjen e tij Shqipëria u administrua nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, i përbërë nga përfaqësues të gjashtë Fuqive të Mëdha. Vidi mbërriti në Shqipëri me 7 mars 1914, dhe me 17 mars 1914 ai krijoi qeverinë. Kryeministër e Ministër i Jashtëm u emërua Turhan Pashë Përmeti, me karrierë diplomatike në Perandorinë Osmane. Qeveria e Vidit u njoh nga ndërkombëtarët si e para qeveri përfaqësuese e shtetit të pavarur shqiptar. Ata filluan të dërgonin përfaqësuesit e tyre pranë Oborrit të Princit.

Kjo periudhë, shënon edhe fillimin e një shërbimi diplomatik të zyrtarizuar për shtetin shqiptar. Emërimet e para të përfaqësuesve diplomatikë të Princ Vidit filluan në maj 1914, në Vjenë dhe në Romë.

Në shtator 1914 filloi Lufta e Parë Botërore, e cila i dha fund shtetit të Vidit. Princi u largua nga Shqipëria më 3 shtator të këtij viti. I mbetur pa struktura shtetërore, vendi u pushtua nga ushtritë e shteteve ndërluftuese në këtë konflikt botëror dhe u kthye në një shesh beteje ndërmjet tyre, pa qenë vetë palë ndërluftuese.

Pas përfundimit të luftës, çështja e statusit dhe e kufijve politikë të shtetit shqiptar u ridiskutua, tashmë në tre tryeza diplomatike; në Konferencën e Paqes në Paris 1919, në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë 1920-1921, dhe në Konferencën e Ambasadorëve II, në Paris 1921. Kjo e fundit rinjohu shtetin e pavarur shqiptar në kufijtë politikë të përcaktuar në Konferencën e Ambasadorëve I, në Londër 1913, me disa rektifikime të vogla në kufijtë veriorë e juglindor të tij.

1.Anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, dhjetor 1920

Krijimi i organizatës së Lidhjes së Kombeve, si pjesë e zgjidhjeve që dha Konferenca e Paqes në Paris, në vitin 1919, me idenë dhe kontributin e madh të presidentit amerikan Wilson, ngjalli shpresa të mëdha për më shumë drejtësi në marrëdhëniet ndërkombëtare, kryesisht për shtetet e reja e të vogla, të krijuara në prag apo pas Luftës së Parë Botërore. Lidhja e Kombeve sillte një element të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare, atë të diplomacisë publike, debatit të hapur dhe sigurisë kolektive.

Qeveria shqiptare, si përfaqësuese e një shteti të vogël të cilit po i kërcenoheshin në Konferencën e Paqes në Paris, statusi dhe kufijtë politikë të përcaktuara që në vitin 1913, e konsideroi anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë si një garanci për një trajtim më të drejtë e më të hapur të çështjes shqiptare, për njohjen e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1913, për shtetin e pavarur shqiptar dhe kufijtë e tij politikë. Ajo shfrytëzoi faktin që më 15 nëntor 1920 do të hapej sesioni i parë i Asamblesë së Lidhjes së Kombeve në Gjenevë të Zvicrës. Më 12 tetor, kryetari i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes Pandeli Evangjeli i drejtoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve Eric Drummond, në të cilën, në emër të popullit shqiptar kërkoi që Shqipëria të pranohej anëtare në Lidhjen e Kombeve e të merrte pjesë në Asamblenë e madhe që do të hapej në Gjenevë më 15 nëntor.

Kërkesa e qeverisë shqiptare për anëtarësim të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve u pasua nga një aktivitet intensiv diplomatik i qeverisë shqiptare dhe delegacioneve të saj në Paris e Gjenevë, e mbështetur edhe nga miq të Shqipërisë dhe shqiptarëve, britanikë e francezë. Kontribut të jashtëzakonshëm dha diaspora shqiptare në botë, e cila jo vetëm mbështeti financiarisht aktivitetin diplomatik në Gjenevë e Paris, por nëpërmjet përfaqësuesve të saj, iu drejtua disa herë Lidhjes së Kombeve dhe kancelarive evropiane me memorandume e peticione në mbështetje të kërkesës së Shqipërisë për t'u pranuar në këtë organizatë, si një shpresë e madhe për një trajtim të drejtë të shteteve të vogla, si Shqipëria.

Më 17 dhjetor 1920, Shqipëria u pranua si anëtare me të drejta të plota në Lidhjen e Kombeve. Delegacioni i parë zyrtar në Gjenevë u kryesua nga Fan Noli, përfaqësues i diasporës shqiptare në SHBA, i ngarkuar me këtë detyrë nga qeveria shqiptare e kohës. Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, një organizatë ndërkombëtare, shënon edhe fillimet e diplomacisë shumëpalëshe për shtetin shqiptar.



Delegacioni shqiptar mbajti gjithmonë një qëndrim aktiv dhe progresist në këtë organizatë, e kryesisht në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve, kudo ku ato ndodheshin.

2.Shqipëria, mbështetëse e projekteve të para evropiane (1929-1931)

Në Asamblenë e 10-të të Lidhjes së Kombeve në vitin 1929, shefi i diplomacisë franceze, Aristide Briand, prezantoi skemën e tij ambicioze për kohën, por të turbullt në formulimin e saj, për krijimin e një *Bashkimi Federal Evropian*, ku do të bënin pjesë të gjitha shtetet evropiane anëtare të Lidhjes së Kombeve. Ky organizëm do të kishte karakter ekonomik.

Propozimi francez, i artikuluar në fjalimin e Briand në Lidhjen e Kombeve më 5 shtator 1929, u formulua në vitin 1930 si “Memorandum mbi organizimin e një regjimi të Bashkimit Federal Evropian”. Ky propozim u mbështet edhe nga Ministri i Jashtëm gjerman Gustav Stresemann, në kuadër të një marrëdhënie të re franko-gjermane, të ndërtuar në këtë kohë. Qeveria franceze kërkoi zyrtarisht qëndrimin e të gjitha shteteve evropiane që përfshiheshin në këtë propozim.

Edhe shteti shqiptar, si anëtar me të drejta të plota në Lidhjen e Kombeve që prej dhjetorit 1920, e mori një kërkesë të tillë nga qeveria franceze. Ministri i Jashtëm shqiptar i kohës, Rauf Fico, dha argumenta interesante në mbështetje të këtij projekti. Analiza e tij, përbënte edhe thelbin e përgjigjes zyrtare që qeveria shqiptare i dorëzoi Ministrin të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Francës në Tiranë, më 15 korrik 1930. Kjo përgjigje iu bashkangjit qëndrimeve të shteteve të tjera evropiane që u bënë publike më 16 korrik 1930. Në mes tjerash, në përgjigjen e qeverisë shqiptare veçojmë “.....*Qeveria shqiptare i ka kushtuar interes të veçantë projektit të qeverisë së Republikës Franceze mbi Bashkimin Federal Evropian, duke besuar që paqja dhe siguria ndërkombëtare, drejt të cilave Bashkimi orientohet, janë kushtet thelbësore dhe të pandashme, falë të cilave shtetet dhe sidomos shtetet e vogla, mund të zhvillojnë mirëqënien e tyre. Prandaj Qeveria mbretërore është plotësisht e njëhsuar me idealin e projektuar nga z.Briand, mbi realizimin e së cilës, duhen krijuar lidhje të reja midis popujve evropiane duke afirmuar atë çka tashmë është krijuar, duke fashitur*

pakënaqësitë që mbizotërojnë aktualisht në marrëdhëniet ndërkombëtare..”.

Në modelin e vendeve të tjera evropiane që kishin mbështetur projektin, qeveria shqiptare me Vendimin nr.735, dt.7.IX.1931, vendosi krijimin edhe të një Komiteti Pan-Evropian në Shqipëri me 4 anëtarë, intelektualë, patriotë, personalitete të shkencës dhe jetës shoqërore. Ky Komitet do të ishte pikë kontakti për këtë projekt.

Në kushtet e fillimit të Depresionit Ekonomik, largimit nga jeta të Ministrit të Jashtëm gjerman Stresseman, largimit nga posti i Ministrit të Jashtëm francez Briand (1932), dy mbështetësit kryesorë të idesë, projekti mbeti i porealizuar, ndërkohë Evropa po hynte në trazirat politike që po përgatisnin Luftën e Dytë Botërore.

3.Shqipëria në konferencat ballkanike të viteve '30-të të shek.XX

Ideja për krijimin e një Pakti Ballkanik në fillim të viteve '30-të të shekullit të kaluar, nxiti qarqet politike të rajonit të organizonin katër konferenca ballkanike në Athinë (1930), në Stamboll (1931), në Bukuresht (1932) dhe në Selanik (1933), të parat në këtë format gjeografik në historinë politike të rajonit. Arsyet që mbështesnin këtë ide, ishin sa politike, aq edhe ekonomike. Shfaqja e nacionalizmit, forcimi i ndikimit bolshevik në rajon, dhe Depresioni i Madh ekonomik i vitit 1929, nxorën në pah

faktin se masat në rrafsh kombëtar ishin të pamjaftueshme për të përballuar krizat ekonomike ndërkombëtare.

Propozimi erdhi nga Greqia, konkretisht nga Aleksandër Papanastasiu, ish-kryeministër i Greqisë. Ai propozoi organizimin e një konference ballkanike gjysëmzyrtare për të shqyrtuar mundësitë e krijimit të një konfederate ballkanike. Propozimi iu bë të gjitha qeverive të rajonit nëpërmjet legatave të tyre në Athinë. Për të lehtësuar procesin e bashkëpunimit dhe shmangur dyshimet ndaj suksesit të kësaj konference, u dakortësua që në konferencë të merrnin pjesë delegacione jozyrtare, përfaqësues të shoqatave, intelektualë e të tjerë, të vendeve të rajonit. Kështu, qeveritë nuk do të ishin të detyruara të zbatonin vendimet e tyre, nëse nuk ishin të përshtatshme politikisht për ta.

Kjo nismë, u mbështet dhe u nxit edhe nga Lidhja e Kombeve. Zyra Ndërkombëtare e Paqes në Gjenevë, në prill 1930, iu drejtohet qeverive të rajonit, ndër to edhe qeverisë mbretërore shqiptare, të merrnin pjesë në këtë konferencë të cilën e vlerësonin si një nismë të dobishme “*..me ofru popujt që kanë midis tyre interesa të posaçme dhe afinitete, për shkak të fqinjësisë, të kushteve ekonomike, të aspiratave kulturore dhe të historisë së tyre. Ky veprim, jo vetëm që asht për të mirën e popujve që thirren të bashkëpunojnë, por përmbledhet edhe prej shpirtit të vetë Lidhjes së Kombeve*”. Qeveria shqiptare, pasi mori informacion nëpërmjet legatave shqiptare për qëndrimin e shteteve të tjera në rajon, vendosi t’i japë propozimit përgjigje pozitive.

Pavarësisht se në konferencë shtetet e rajonit u përfaqësuan nëpërmjet grupeve kombëtare, të përbëra nga deputetë, profesorë, elitë intelektuale e angazhuar në politikat e vendit, e të tjerë, këto grupe ishin zgjedhur nga qeveritë, pra nuk ishin jashtë fokusit të tyre. Mbretëria shqiptare në këtë konferencë u përfaqësua nga Mehmet Konica, kryetar i Komisionit të Jashtëm në parlamentin shqiptar, Mid'hat Frashëri dhe At' Gjergj Fishta, patriotë me kontribute të mëdha në jetën politike e intelektuale të vendit për kohën. Për shkak të mosmarrëveshjeve konferenca e Athinës u pasua nga tre të tjera me të njëjtin objektiv pune.

Gjatë konferencave u ngritën një numër komisionesh për të trajtuar probleme jopolitike. Këto komisione përgatitën një numër projektesh të konsideruara, asokohe të vlefshme dhe konstruktive, disa prej të cilave edhe u zbatuan. Këtu përfshiheshin shkëmbimet e profesorëve dhe studentëve të universiteteve, ngritja e një Instituti të Historisë së Ballkanit e të një Dhome Tregtie dhe Industrie të Ballkanit, adoptimi i planeve për një Zyrë Pune Ballkanike apo Unioni Postar. Përfaqësuesit e Shqipërisë i mbështetën të gjitha këto projekte duke marrë pjesë aktivisht në komisionet e ngritura.

Në çështjet politike, avancimi ishte shumë i ngadaltë, pasi ndërhynte qëndrimi i delegacioneve për respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në vendet ku ndodheshin pas formimit të hartës së re politike të Ballkanit. Kjo bëri që Pakti Ballkanik i krijuar pas konferencës së katërt, të mos ishte plotësisht i tillë pasi në të nuk merrnin pjesë Bullgaria e Shqipëria. Shqipëria u tërhoq nga konferenca

e tretë dhe e katërt në shenjë mosaprovimi me trajtimin e çështjes së popullsisë shqiptare, të mbetur jashtë kufirit politik të shtetit shqiptar.

Gjithsesi, këto konferenca ishin një ushtrim i mirë për Shqipërinë, sikurse edhe për vendet e tjera të rajonit, lidhur me negociimin e problemeve, në një rrafsh më të gjërë se ai dypalësh, gjetjen e interesave të përbashkëta për bashkëpunim, të paktën në fushat e aktivitetit kulturor, ekonomik dhe social.

4. Pranimi i Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, 14 dhjetor 1955.

Pranimi i Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ka qenë një ndër problemet e rëndësishme të politikës së jashtme të shtetit shqiptar menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, si garanci për forcimin e pozitave ndërkombëtare të tij, në botën e pasluftës. Që në mars 1945, qeveria shqiptare e kohës kishte kërkuar pranë Fuqive aleate antifashiste, nismëtare të krijimit të OKB-së, që Shqipëria të konsiderohej si anëtare themeluese e kësaj organizate për hir të pjesëmarrjes së popullit shqiptar në koalicionin e madh antifashist të popujve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fuqitë nismëtare të krijimit të kësaj organizate kishin rënë dakort të mos ftonin në konferencën themeluese të OKB-së në San Francisko qeveritë që nuk ishin njohur akoma formalisht nga Fuqitë aleate dhe me të cilat si pasojë nuk ishin vendosur marrëdhënie zyrtare. Qeveria e ShBA-ve, nuk e njohu qeverinë komuniste shqiptare të pas luftës në

Shqipëri, ndaj ajo nuk mund të ftohej në konferencën themeluese të OKB-së. Kjo iu komunikua Tiranës zyrtare.

Qeveria shqiptare vazhdoi këmbënguljen e saj për anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë, por tashmë jo si shtet themelues, por si anëtare e OKB-së. Në vitin 1946 qeveria shqiptare kërkoi që vendi të pranohej në OKB në kuadrin e dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Komiteti i Pranimeve të Anëtarëve të Rinj kërkoi informacione shtesë për të shoqëruar aplikimin e qeverisë shqiptare, ndër të tjera mbi zgjidhjen e problemeve në marrëdhëniet me Greqinë, qëndrimin e qeverisë komuniste të Tiranës ndaj vlershmërisë së traktateve dhe marrëveshjeve në fuqi, të nënshkruara para 7 prillit 1939, midis Shqipërisë dhe shteteve anëtare të OKB-së, apo informacion zyrtar për zhvillimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese të 2 dhjetorit 1945, etj. Përgjigjet e marra nga pala shqiptare në ato vite nuk i kënaqnin të gjithë anëtarët e organizatës dhe kështu kërkesa e Shqipërisë për antarësim në OKB rrezohej.

Shumë probleme që dolën asokohe ndërmjet Shqipërisë e Greqisë, u bënë shkak debatesh në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në kontekstin e Luftës së Ftohtë dhe kristalizimit të dy blloqeve kundërshtarë politike e ushtarake. Situatën e rëndoi edhe i ashtëquajtimi “Incidenti i Kanalit të Korfuzit” në marrëdhëniet me Britaninë e Madhe, si dhe prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë e Titos në 1948, e cila e kishte mbështetur në fillim kërkesën e Shqipërisë.

Ne vitin 1954, Ministri i Jashtëm Behar Shtylla që ishte edhe *Observer Permanent* i Shqipërisë pranë OKB-së, në kërkesën drejtuar Asamblesë së Përgjithshme në emër të qeverisë shqiptare, ndër të tjera shprehej se qeveria shqiptare pranonte pa asnjë rezervë të gjitha detyrimet që rridhnin nga Karta e OKB-së dhe se ishte e gatshme t'i plotësonte ato. Kërkesa përfundonte me deklaratën se ...”vendimi për pranimin e Shqipërisë në OKB do të ishte në pajtim të plotë me parimet e larta të Kartës dhe me vullnetin e popujve që Kombet e Bashkuara të jenë një qendër ndërkombëtare ku të bashkohen dhe të bashkëpunojnë të gjitha shtetet e lira dhe sovrane, pavarësisht nga sistemet e tyre politike e shoqërore.”

Tashmë shteti shqiptar kishte zgjeruar numrin e shteteve me të cilat kishte vendosur marrëdhënie diplomatike, ishte forcuar miqësia me Bashkimin Sovjetik, anëtar i Këshillit të Sigurimit, po bëheshin përpjekje për normalizimin e marrëdhënieve me Greqinë, Shqipëria ishte bërë pjesë në disa konventa ndërkombëtare apo organizata ndërkombëtare, ndër to edhe në organizata të specializuara të OKB-së si UNRRA, etj.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në mbledhjen e saj plenare të mbajtur më 14 dhjetor 1955, duke vepruar në bazë të rekomandimit të Këshillit të Sigurimit, mori në shqyrtim kërkesën e Shqipërisë dhe vendosi ta pranonte atë si anëtare të Kombeve të Bashkuara, së bashku me 15 shtete të tjera. Më 15 dhjetor u njoftua zyrtarisht qeveria shqiptare për vendimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe tre ditë më pas u caktua

delegacioni i saj zyrtar në sesionin e dhjetë të Asamblesë së Përgjithshme.

Që nga ajo kohë, Shqipëria ka gëzuar pa ndërprerje statusin e shtetit anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në të mirë të paqes, mirëkuptimit dhe zgjidhjes së problemeve ndërkombëtare me mjete paqësore.




Në tetor 2009, Shqipëria shpalli zyrtarisht kandidaturën e saj për anëtare të KDNJ-së për periudhën 2015-2017. Në zgjedhjet që u zhvilluan në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork, më 21 tetor 2014, Shqipëria u zgjodh për herë të parë anëtare e KDNJ-së, me 176 vota. Gjatë vitit 2015, Shqipëria është zgjedhur edhe anëtare e Byrosë së KDNJ-së si dhe Zëvendës-presidente e KDNJ-së, si përfaqësuese e grupit të Evropës Lindore. Shqipëria kandidon për anëtare jo të përhershme në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për vitin 2022-2023. Në vitin 2020 përfaqësuesja e Shqipërisë u zgjodh në postin e Zëvendës-presidentes të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për Sesionin e 75-të të saj.

5. Pranimi i Shqipërisë në UNESCO, 16 tetor 1958.


Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO zgjati 12 vite, nga shprehja zyrtarisht e dëshirës së shtetit shqiptar të kohës, në nëntor 1946, për të qenë anëtar i kësaj organizate.

Sipas nenit 2 të Konventës të UNESCO-s, kishin të drejtë të ishin anëtarë të kësaj organizate të gjitha shtetet anëtare të OKB-së. Shtetet jo-anëtare të OKB-se duhej të aplikonin për të marrë si fillim një rekomandim nga Këshilli Ekonomik dhe Shoqëror i OKB-së. Qeveria shqiptare bëri dy herë kërkesë për këtë rekomandim, në vitin 1946 dhe 1954, por kërkesa u refuzua.



Pas pranimit të Shqipërisë si anëtare e OKB-së, në dhjetor 1955, procedura e pranimit të saj në UNESCO ishte shumë më e thjeshtë. Në tetor 1958, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Konventën themeluese të UNESCO-s të 16

nëntorit 1945. Me 16 tetor 1958, titullari i legatës shqiptare në Paris, nënshkroi në Londër Aktin e Themelimit të UNESCO-s dhe dorëzoi instrumentin e pranimit pranë qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Po atë ditë, Zyra e Jashtme njoftoi telegrafisht Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s mbi përfundimin e procedurave nga pala shqiptare, dhe që nga ajo datë, 16 tetor 1958, Shqipëria u bë anëtare efektive e UNESCO-s.



Kështu nisi edhe bashkëpunimi i Shqipërisë me këtë organizatë, me angazhime dhe prioritete të ndryshme sipas rrethanave politike, por gjithmonë një bashkëpunim i frytshëm për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare.

6.Shqipëria në aktivitetet ballkanike gjatë Luftës së Ftohtë

Gjatë Luftës së Ftohtë, shtetet ballkanike të ndara politikisht sipas pjesëmarrjes së tyre, në blloqet e mëdha politiko-ushtarake të krijuara, nuk ofronin një terren të favorshëm që të nxiste bashkëpunimin e gjërë rajonal. Shqipëria e gjendur jashtë blloqeve pas përplasjeve politike e ideologjike me Moskën zyrtare, në vitin 1961, e kishte akoma më të kufizuar hapësirën e saj të bashkëpunimit në rajon.

Në përpjekje të mundimshme për të gjetur pika bashkëpunimi në botën e ashpër të blloqeve politike e ushtarake të Luftës së Ftohtë, që nga viti 1959 në vendet e rajonit ishin formuar Komitetet e Mirëkuptimit Ballkanik, me pjesëmarrës nga shoqëria civile, rrethe intelektuale nga fusha të ndryshme të artit, sportit, arsimit, shkencës, e të tjera, të cilat kishin si qëllim të forconin miqësinë midis popujve në rajon, pavarësisht diferencave politike. Ky Komitet, nën kontrollin e rreptë të qeverisë së kohës, funksiononte edhe në Shqipëri. Përfaqësues të këtyre komiteteve u mblodhën disa herë me synim krijimin e një Komiteti koordinimi ndërballkanik të miqësisë mes popujve. Takimi i parë ndodhi më 15 prill 1961 në Athinë, por delegacioni shqiptar nuk mori dot vizë hyrje në Greqi për shkak të marrëdhënieve të tensionuara me Greqinë. Më pas, takimet u zhvilluan në Sofje në nëntor 1961, në Beograd në qershor 1964, dhe në të dy rastet Shqipëria nuk u ftua pas prishjes së marrëdhënieve të saj me BRSS dhe forcimin e miqësisë me Kinën komuniste, po ashtu jashtë blloqeve. Takimi i

fundit i këtyre komiteteve ndodhi në maj 1965. Shqipëria u ftua në këtë takim, por qeveria shqiptare e kohës nuk lejoi pjesëmarrjen e përfaqësuesve shqiptarë. Në pamundësi për të kapërcyer pengesat e ndryshimeve politike mes shteteve ballkanike, këto komitete nuk u mbledhën më.

Përveç Komiteteve të Mirëkuptimit Ballkanik, gjatë periudhës 27 vjeçare, 1960-1987, nga shtete të ndryshme të rajonit u organizuan rreth 140 aktivitete rajonale në fushën e mjekësisë, të sporteve, të kulturës, të arsimit, si dhe me karakter shkencor e teknik në degë të ndryshme. Shqipëria mori pjesë vetëm në 66 prej tyre, kryesisht me karakter sportiv, ose në arsim e shkencë. Shqipëria nuk mori pjesë as në mbledhjen e ekspertëve për bashkëpunim ekonomik e teknik midis vendeve ballkanike, të propozuar nga pala greke e të organizuar në Athinë, në 26 janar - 5 shkurt 1976, meqenëse ky takim zhvillohej në frymën e Aktit Final të Helsinkit, 1 gusht 1975, të cilin Shqipëria nuk e kishte nënshkruar akoma.

Arsyeja e mospjesëmarrjes së Shqipërisë në shumicën e aktiviteteve ballkanike, kryesisht ato me karakter politik, ishte qëndrimi politik i qeverisë shqiptare se në Ballkan nuk ekzistonin kushtet e nevojshme për bashkëpunim rajonal, pa u zgjidhur më parë problemet dypalëshe.

7. Shqipëria në takimin e parë të Ministrave të Punëve të Jashtme të të gjitha vendeve të Ballkanit, 24-26 shkurt 1988. Rritja e angazhimit të saj rajonal.

Pas përmirësimit të klimës së marrëdhënieve midis dy blloqeve politike të Luftës së Ftohtë dhe fillimit të takimeve Regan-Gorbaçov, në gjysmën e dytë të viteve '80-të, edhe 6 shtetet ballkanike të mbërthyer në formulën 2+2+2 për shkak të përkatësisë së tyre në blloqe të ndryshme politike, ose qëndrimit jashtë blloqeve, si Shqipëria e ish-Jugosllavia, filluan përpjekjet për të gjetur rrugët e bashkëpunimit në rajon, për të zgjidhur problemet e përbashkëta, duke tejkalluar pengesat politike.

Në 29 maj 1987 Sekretari Federativ për Punët e Jashtme i ish-Jugosllavisë Raif Dizdareviç u dërgoi letër ministrave të jashtëm të të gjithë vendeve të Ballkanit, ku propozonte organizimin e një takimi të të gjithë ministrave të jashtëm të shteteve të rajonit, deri në fund të vitit 1987. Rendi i ditës i takimit u propozua nga pala jugosllave në cilësinë e organizatores, si “*..Shkëmbim mendimesh lidhur me idetë, rrugët e mundësitë për zhvillimin e bashkëpunimit shumëpalësh në Ballkan, në të gjitha fushat ku interesat e vendeve ballkanike përputhen dhe ku nevojat janë të përbashkëta*”.

Ftesa mbërriti edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më 29 maj 1987. Bazuar në qëndrimin e vazhdueshëm të qeverive shqiptare të kohës se “*.. në situatën konkrete në Ballkan, nuk ekzistojnë kushtet e domosdoshme e të nevojshme për një mbledhje me karakter ballkanik dhe marrëveshje shumëpalëshe, pa*

zgjidhur më parë problemet dy-paleshe”, Ministria e Punëve të Jashtme u rezervua të japë pëlqimin që në fillim.

Pas shumë dilemash politike, në kushtet e fillimit të hapjes së detyruar, por të kontrolluar, në politikën e jashtme shqiptare, pas një diskutimi të gjatë me rangje të ndryshme diplomatike me vendet e rajonit, qeveria shqiptare vendosi pjesëmarrjen në këtë takim kaq të rëndësishëm për rajonin, me kusht që të respektohej rendi i dites i propozuar. Ajo u përgjigj zyrtarisht më 15 tetor 1987.

Për shkak të konsultimeve të shumta midis qeverive të vendeve të Ballkanit që i përkisnin realiteteve të ndryshme politike, dhe vështirësive për të gjetur një dakordësi për qëllimin e takimit dhe formatin e tij, takimi nuk u realizua dot brenda vitit 1987, por më 24-26 shkurt 1988.

Shqipëria mori pjesë për herë të parë në një takim të këtij formati në rajon, ndaj ky ishte takimi i parë politik me pjesëmarrje të plotë nga vendet e një rajoni problematik në marrëdhëniet ndërshtetërore si Ballkani i viteve '80-të. Si i tillë, ky takim ishte i një rëndësie të veçantë. Takimi u mbyll me një Komunikatë të Përbashkët të arritur pas shumë diskutimesh jo të lehta diplomatike. Ndër të tjera, në Komunikatë thuhej se “...*duke respektuar sistemet e ndryshme politike, social-ekonomike të vendeve ballkanike, të pavarësisë, të sovranitetit, integritetit të tyre territorial, paprekshmërisë së kufijve, të drejtave të barabarta, mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe*

interesit reciprok, ministrat ranë dakort të bëjnë përpjekje të reja për të zhvilluar një bashkëpunim shumëpalësh dhe të gjithanshëm, si dhe marrëdhënie reciproke midis vendeve ballkanike.”

Ky takim, shënoi një pikë të fuqishme kthese në angazhimin e Shqipërisë në kontekstin rajonal. Pas pjesëmarrjes së Shqipërisë në mbledhjen e parë të Ministrave të Punëve të Jashtme të të gjitha vendeve të Ballkanit, Beograd në shkurt 1988, Tirana zyrtare e rriti angazhimin e saj për nxitjen e bashkëpunimit në rajon në kuadër të përpjekjeve për një imazh të ri për politikën e jashtme shqiptare. Në mbledhjen e Beogradit, delegacioni shqiptar propozoi riaktivizmin e Komiteteve të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit Ballkanik (KMBB) që kishin funksionuar në fillim të viteve '60-të, me pjesëmarrës nga shoqëria civile, rrethe intelektuale nga fusha të ndryshme të artit, sportit, arsimit, shkencës, e të tjera, madje propozuan që takimi i parë i këtyre komiteteve të organizohej në Tiranë, ku të diskutoheshin mundësitë e bashkëpunimit mes të rinjve, studentëve, sportistëve, organizatave joqeveritare, etj. Propozimi u miratua nga ministrat e jashtëm të rajonit. Në Shqipëri ky Komitet u mblodh dy herë brenda vitit 1988. Këto komitete përgatisnin një terren më bashkëpunues edhe për fusha të tjera më delikate, me interes reciprok midis vendeve të rajonit.

Takimi i parë i KMBB-së u organizua në Tiranë, më 18-19 tetor 1989 dhe ishte takimi i parë në nivel jo qeveritar që bëhej në Ballkan me pjesëmarrje të plotë. Ky takim dhe kontributi i Shqipërisë për organizimin e tij u përshëndet

nga OKB-ja dhe përfaqësues të shteteve të tjera të akredituar në Tiranë, si një kontribut i vyer për vendosjen e një klime miqësie e mirëkuptimi në Ballkan.

8.Vizita në Shqipëri e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Javier Peres de Cuelar, 11-13 maj 1990.

Në kuadër të përpjekjeve të presidentit të fundit komunist, Alia, për një hapje të kontrolluar të Shqipërisë pa prekur pushtetin politik, përmirësimin e imazhit në arenën ndërkombëtare si dhe rritjen e besueshmërive politike të tronditura brenda vendit, në kohën kur tërë vendet komuniste të lindjes së Evropës ishin përfshirë në valën e revoltave popullore për ndryshime të pakthyeshme politike, Ministri i Jashtëm Reis Malile gjatë sesionit të 44-t të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në tetor 1989, ftoi zyrtarisht Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Javier Peres De Kuelar dhe zonjën De Kuelar për një vizitë në Shqipëri. Presidenti De Kuelar e pranoi ftesën dhe vizita u planifikua të zhvillohej më 11-13 maj 1990.

Ky ishte një zhvillim i rëndësishëm për politikën e jashtme të Shqipërisë së asaj kohe, që e shikonte me rezerva OKB-në dhe misionin e saj për shkak të peshës që kishin atje ShBA-të e BRSS, me të cilat Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike. Aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë reagueshan që kjo vizitë të mos zhvillohej, me argumentin se në Shqipëri shkeleshin të drejtat e njeriut. Në mars të vitit 1990, Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Gjenevë miratoi një Rezolutë mbi të drejtat e njeriut në Shqipëri. Në këtë Rezolutë mbahej shënim që

gjetjet e saj të mbaheshin parasysh gjatë vizitës së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Tiranë. Vizita do të ishte pjesë e turneut të De Kuelar në Evropën Lindore që përfshinte Hungarinë dhe Çekosllovinë.

Në Shqipëri, De Kuelar u prit nga Presidenti i Republikës, dhe pati takime pune me Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme. De Kuelar u vu ne dijeni se Shqipëria kishte vendosur të bashkohej me proceset e sigurimit dhe bashkëpunimit evropian. Ai përshëndeti hapjen e Shqipërisë në politikën e jashtme, bashkëpunimin në mënyrë aktive me shtetet e tjera të Ballkanit, propozoi hapjen e një zyre të PNUD në Shqipëri, aderimin në konventën e të drejtave të njeriut, përfaqësimin e Shqipërisë me punonjësit e saj në Sekretariatit e OKB-së, si dhe premtoi që të nxiste bashkëpunimin e Komisionit Ekonomik për Evropën për t'i dhënë Shqipërisë ndihmë ekonomike në përpjekiet e saj për të kryer reforma .

Gjatë kësaj vizite, De Kuelar adresoi edhe disa raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në Shqipëri, të evidentuara në rezolutën e Komisionit të të Drejtave të Njeriut, duke kërkuar një qëndrim të drejtë nga qeveria shqiptare në përputhje me Deklaratën e Përgjithshme të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Vizita e tij shërbeu edhe për zgjidhjen e incidentit të vëllezërve Popaj, të cilët kishin hyrë në ambasadën italiane në Tiranë që në dhjetor të vitit 1985, për të kërkuar azil politik. Ky incident kishte mbajtur të ngrira marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve për mbi 4 vite. Menjëherë pas largimit të De Kuelar, Popajt u pajisën me pashaportë shqiptare për udhëtim jashtë shtetit dhe u lejuan të largohen për në Itali nëpërmjet ambasadës

italiane në Tiranë. Kjo ngjarje nxiti shumë shqiptarë të tjerë të hynin në selitë e ambasadave të huaja në Tiranë, më 2 korrik 1990, duke kërkuar azil politik, ngjarje që tronditi regjimin komunist në Shqipëri, dhe shëmbi “Murin e Berlinit” në Shqipëri.

9.Shqipëria organizon takimin e dytë të Ministrave të Punëve të Jashtme të Ballkanit, Tiranë 24-25 tetor 1990

Ndërkohë që po përgatitej të trokiste për anëtarësim në dyert e KSBE-së, por edhe të TPE-së për të siguruar mbështetjen ekonomike të disa vendeve anëtare, qeveria shqiptare filloi të intensifikojë marrëdhëniet me çdo shtet ballkanik si nje hap me ndikim pozitiv në forcimin e bashkëpunimit shumëpalësh. Në takimin e MPJ-ve të Ballkanit në Nju Jork, më shtator 1988, gjatë zhvillimit të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, u shpreh hapur dëshira për rritjen e mëtejme të bashkëpunimit ballkanik. Ky qëndrim i përbashkët u pasua menjëherë nga mbledhja e Zëvendësministrave të Jashtëm të vendeve të Ballkanit në Tiranë në 18-20 janar 1989. Në këtë takim, Shqipëria bëri ftesën e saj që edhe mbledhja e dytë e MPJ-ve të Ballkanit të zhvillohej në Tiranë gjatë vitit 1990.

Në 18-19 tetor 1989 u zhvillua mbledhja e Komiteteve të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit Ballkanik, e cila vendosi që mbledhja e dytë e MPJ-ve të Ballkanit të mbahej në vjeshtë të vitit 1990. Pas konsultimeve të gjata dypalëshe, më 1 shtator 1990, Ministri i Jashtëm Malile i

dërgoi një letër të gjithë homologëve të tij në rajon, ku i njofton për datën e takimit dhe rendin e tij të ditës së përcaktuar, një element që mungonte në mbledhjen e parë në Beograd dhe që ishte kritikuar nga pala shqiptare.

Takimi u zhvillua ne 24-25 tetor 1990, me pjesëmarrjen e plotë të MPJ-ve të Ballkanit. Në takim vihej re një qasje më e spikatur e shefave të diplomacisë së rajonit ndaj frymës së re në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe qëndrimit bashkëpunues me KSBE. Edhe ky takim u mbyll me një Komunikatë të Përbashkët, thelbi i të cilës iu percoll si mesazh nga mbledhja e Ministrave te Punëve të Jashtme të shteteve ballkanike takimit të Kryetarëve të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të KSBE-së të mbledhur në Paris më 19-21 nëntor 1990, për të reflektuar për një strategji të re pas rrëzimit të komunizmit në vendet e Evropës Lindore e Qëndrore. Në këtë mesazh, ndër të tjera, të gjitha vendet e Ballkanit u shprehën se përshëndetnin kërkesën e Shqipërisë për pjesëmarrje të plotë në KSBE, si i vetmi vend në rajon jashtë saj, dhe shprehnin dëshirën që kjo kërkesë të realizohej.

Ky takim u përshëndet nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Peres de Kuelar dhe nga shumë kryetarë shtetesh apo figura të shquara, mes tyre edhe Shenjtorja e madhe, Nënë Tereza.

10. Anëtarësimi i Shqipërisë me të drejta të plota në Konferencën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë KSBE (OSBE që nga viti 1995), 19 qershor 1991.

Në kuadër të ndryshimeve të fuqishme politike që po ndodhnin në Lindje e që po nxisnin thirrjen e një “Helsinki 2”, si dhe krizës ekonomike e politike ku kishte hyrë vendi nga vetëizolimi, udhëheqja politike e kohës parashtrroi që në fillim të vitit 1990 nevojën për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në KSBE. Ishte i vetmi vend evropian që nuk kishte nënshkruar Aktin e Helsinkit në 1 gusht 1975. Qeveria shqiptare e bëri publik këtë vendim pak ditë para vizitës në Shqipëri të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, De Kuellar. Shqipërisë, në kushtet e vitit 1990 iu ofrua vetëm statusi i vëzhguesit në aktivitetet e KSBE-së, duke filluar nga mbledhja e KSBE-së në Kopenhagë për çështjet humanitare, 5-29 qershor 1990.

Me kërkesën e tij, një delegacion i Komisionit të Helsinkit mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë në Uashington, vizitoi Shqipërinë në fillim të gushtit 1990 dhe gjeti që Shqipëria e asaj kohe ishte akoma larg parimeve dhe normave të Helsinkit në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në fusha të tjera që garantonin anëtarësinë e plotë në KSBE, pavarësisht disa masave liberalizuese që kishin nisur të merreshin në fushën e legjislacionit. Ata prematuan të mbështesnin statusin e vëzhguesit për Shqipërinë.

Duke e konsideruar takimin e Nivelit të Lartë në Paris, ose Helsinki-2, si një moment shumë të përshtatshëm për Shqipërinë për t'u bashkuar me të drejta të plota në procesin e Helsinkit, në emër të qeverisë shqiptare, Ministri i Jashtëm Malile i dërgoi më 12 shtator 1990 një letër-kërkesë për mbështetjeje Sekretarit të Shtetit Xheims Bejker si vend mikpritës i takimit përgatitor të Ministrave të Puneve të Jashtme të vendeve anëtare të KSBE-së, që do të mbahej në Nju Jork më 1-2 tetor, Ministrin të Jashtëm të Francës Roland Dumas si vend organizator i takimit të Parisit, si dhe Ministrin të Jashtëm të Finlandës Pertti Passio si vend depozitues i Aktit të Helsinkit. Qeveria shqiptare kërkonte që në agjendën e Takimit të Parisit të përfshihej edhe çështja e pranimit të Shqipërisë si anëtarja e 35-të e KSBE-së. Nga ana tjetër qeveria shqiptare, me kërkesën e hershme të ndërkombëtarëve bëri një deklaratë publike më 15 shtator 1990, ku theksonte njohjen dhe pranimin e dokumenteve të KSBE-së.

Mbledhja e Nju Jork-ut nuk pati dakordësi të plotë për Shqipërinë dhe vendosi pjesëmarrjen e saj vetëm si vëzhguese në takimin e Nivelit të Lartë në Paris, i cili do të mbahej me 19-21 nëntor 1990. Në takimin e Parisit, delegacioni shqiptar me statusin e vëzhguesit bëri për mediat një deklaratë zyrtare nëpërmjet të cilës përshëndeste “*proceset pozitive evropiane të KSBE-së dhe shprehte vullnetin e palëkundur për t'u bashkuar plotësisht me të*”. Këtë kërkesë e mbështetën plotësisht vendet e Ballkanit, anëtare të KSBE-së, tashmë që Shqipëria kishte filluar të merrte pjesë politike aktive në

takimet rajonale të ministrave të jashtëm (Beogradi në 1988 dhe Tirane në 1990).

Rrethanat që mundësuan dhe shpejtuan procesin e aderimit të Shqipërisë në KSBE, do të ishin lëvizja demokratike e dhjetorit të vitit 1990, zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri në mars 1991, si dhe miratimi i Paketës Kushtetuese Provizore më 29 prill 1991, e cila përmbante dispozita që pranonin pluralizmin politik dhe respektimin e të drejtave të njeriut

Në 19-21 qershor 1991, në Berlin, do të mbahej takimi i parë i Këshillit të Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të KSBE-së, pas institucionalizimit të procesit. Në maj të vitit 1991 qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, filloi fushatën lobuese për kandidaturën e Shqipërisë si anëtare e plotë në organizatë. Për këtë iu drejtua disa herë të gjitha ministrive të jashtme të vendeve anëtare të KSBE-se, duke sjellë në vëmendjen e tyre faktet se si “*..Shqipëria po avanconte në ndërtimin e një demokracie pluraliste, respektimin e plotë të drejtave të njeriut, vendosjen e një ekonomie tregu, në ndërtimin e sundimit të ligjit, dhe se kishte pranuar plotësisht trashëgiminë e vlerave të përbashkëta evropiane*”. Disa nga vendet anëtare kërkuan që të dërgohej në Shqipëri para takimit të qershorit në Berlin një “*fact-finding*” apo “*rapporteur mission*” i KSBE-së dhe raporti i tyre t’i vihej para ministrave të jashtëm në takimin e Berlinit, në qershor.

Më 10 qershor 1991, duke përshëndetur edhe rivendosjen e marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe SHBA-

ve në mars 1991, Komisioni mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (Komisioni i Helsinkit) me qendër në Uashington, publikoi qëndrimin e tij të ri në mbështetje të kërkesës së Shqipërisë për anëtarësi të plotë në KSBE, në takimin e Berlinit..”*Ne besojmë - shprehej Komisioni - se ka ardhur koha të mbështesim kërkesën e Shqipërisë për t’u bërë një anëtare e plotë e KSBE-së , duke e angazhuar atë në mënyrë të barabartë në ndërtimin e të ardhmes së Evropës si e tërë, dhe për të mbështetur sigurinë, ekonominë e tregut, standartet e të drejtave të njeriut dhe të drejtat mjedisore që udhëheqin marrëdhëniet ndërmjet shteteve anëtare të KSBE-së”*. Komisioni u shpreh se situata tashmë ishte përmirësuar dukshëm në raport me gushtin e vitit 1990. Ata propozonin që pas antarësimit, qeveria shqiptare do të mbante përgjegjësinë për angazhimet e marra me vullnetin e saj të lirë në Aktin Final të Helsinkit dhe në të gjitha dokumentat vijuese të KSBE-së. Situata do të monitorohej nga Misioni raportues i organizatës.

Propozimi u mbështet edhe nga anëtarë të tjerë deri atëhere skeptikë për Shqipërinë, duke e konsideruar një mbështetje për popullin shqiptar në rrugën e demokracisë. Më 11 qershor u formua qeveria e parë pluraliste pas Luftës së Dytë, e njohur si Qeveria e Stabilitetit. Më 14 qershor, 5 ditë para takimit, qeveria pluraliste shqiptare nëpërmjet Ministrisë të Punëve të Jashtme, Muhamet Kapllani iu drejtua zyrtarisht përsëri të gjitha shteteve anëtare të KSBE-së që të mbështesin kërkesën e Shqipërisë për t’u pranuar si anëtare e plotë e kësaj organizate.

Më 19 qershor 1991, në ndërtesën e Raishtagut në Berlin, u hap mbledhja e ministrave të jashtëm të vendeve pjesëmarrëse në KSBE. Takimi kryesohej nga Zëvendës Kancelari dhe Ministri i Jashtëm i RF të Gjermanisë Hans Dietrich Gensher, si kryetar i mbledhjes. Delegacioni shqiptar kryesohej nga Ministri i Punëve të Jashtme Kapllani dhe përbëhej edhe nga përfaqësues të të gjitha forcave politike të krijuara deri në atë kohë në Shqipëri. Në unanimitet të plotë dhe me duartkritje u miratua pranimi i Shqipërisë si anëtare me të drejta të plota në KSBE. Delegacioni shqiptar zuri vendin si anëtari i 35-të i KSBE. Kanali televiziv i lajmeve CNN, pasi dha njoftimin për mbledhjen e qershorit në Berlin dhe ceremoninë e pranimin të Shqipërisë në KSBE, e përfundonte lajmin “*Tani me demokratizimin e Shqipërisë, Evropa u bë e plotë.*”

Më 16 shtator 1991, në orën 16.00, Presidenti i Republikës së Shqipërisë firmosi në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Finlandës Aktin Final të Helsinkit në prani të përfaqësuesve të shteteve anëtare. Kjo konfirmonte pranimin nga ana e Shqipërisë të parimeve dhe normave të Aktit Final. Ndërsa me 17 shtator 1991 Presidenti firmosi edhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re. Tashmë Shqipëria mbante mbi supë angazhimet e plota për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rridhnin nga këto dy akte të rëndësishme ndërkombëtare.

Ky aderim shënoi një ndryshim rrënjësor të kursit të politikës së jashtme shqiptare, në afrimin me bashkësinë euro-atlantike dhe në pranimin e vlerave perëndimore të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

11.Shqipëria vendos marrëdhënie diplomatike me Komunitetin Ekonomik Evropian, 20 qershor 1991.

Nga kontaktet që trupi diplomatik shqiptar i akredituar në vende të ndryshme të Evropës kishte me institucionet përgjegjëse, qeveria shqiptare mori informacion se në 1992, me krijimin e tregut të brendshëm evropian, bashkësia evropiane do të vepronte si një organizëm i vetëm dhe i fuqishëm ekonomik, masat proteksioniste për të hyrë në këtë treg do të ishin më të forta dhe do të bëhej më i vështirë eksporti në këtë zonë, prandaj të gjitha vendet po merrnin masa për t'ju përshtatur gjendjes së re që do të krijohet në vitin 1992, duke u lidhur me bashkësinë evropiane në forma të ndryshme. Shtetet partnere të Shqipërisë në fushën e bashkëpunimit ekonomik që ishin apo do të bëheshin anëtare të Bashkësisë Evropiane do të kishin vështirësi të bashkëpunonin me Shqipërinë që nuk kishte asnjë lidhje me këtë bashkësi. Ata njoftuan Tiranën zyrtare se disa të drejta sovrane në fushën ekonomike ia kishin dorëzuar Brukselit dhe nuk ishin në gjendje të nënshkruanin vetë disa lloj marrëveshjesh ekonomike me Shqipërinë.

Në kushtet kur funksionarë të disa vendeve perëndimore refuzonin të hynin në bisedime me autoritetet shqiptare pa marrë udhëzime nga Brukseli, qeveria shqiptare udhëzoi ambasadorin e saj në Paris në prill 1989 që të merrte takim me Jacques Delor, President i Komisionit Evropian (1985-1995), por ky takim u refuzua nga Kabineti i Delor përse kohë Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike me KEE. Shqipërisë iu refuzuan edhe kërkesat për blerjen e mallrave stoqe të Komunitetit me çmime preferenciale.

Filluan përpjekjet për të zgjidhur ngërçin që sa vinte e bëhej më i vështirë për qeverinë shqiptare në fushën ekonomike. TPE tashmë kishte përfshirë në sferën e saj të integritit, direkt ose indirekt, të gjithë Evropën perëndimore. Shqipëria duhej të njihte Komunitetin Ekonomik Evropian që të nënshkruante marrëveshje tregtare dhe ekonomike, apo të përfitonte kontribute financiare nga ky organizëm dhe anëtarët e tij. Qeveria shqiptare vendosi në prill 1990 për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Ekonomik Evropian.

Më 4 maj 1990, MPJ Reis Malile i drejtoi një letër Presidentit të Komisionit Evropian Jacques Delor, nëpërmjet ambasadorit shqiptar në Paris, i akredituar edhe në Bruksel. Me anë të kësaj letre propozohej vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian. Një kopje e saj iu dorëzua ambasadorit irlandez në Paris, meqë Irlanda kishte kryesinë e Këshillit të Ministrave të Komunitetit Evropian, Një kopje u dorëzua edhe në Ministrinë italiane të Punëve të Jashtme, meqenëse Italia do të merrte kryesinë në 1 korrik 1990.

Pas paraqitjes së kërkesës nga ana e qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Komunitetin Ekonomik Evropian, filloi puna për lobim diplomatik për mbështetjen e kërkesës së paraqitur. Nga burime diplomatike autoriteteve shqiptare u ishte bërë e qartë që vendet anëtare të Komunitetit do ta trajtonin kërkesën e

qeverisë shqiptare të lidhur edhe me ecurinë e saj në axhendën e antarësimit në KSBE.

Ngjarjet e 2 korrikut 1990, kur mijëra qytetarë shqiptarë hynë dhe u strehuan në rezidencat e përfaqësive të huaja diplomatike në Tiranë, kryesisht në katër përfaqësitë e vendeve anëtare të Komunitetit Ekonomik Evropian (Franca, RFGJ, Italia, Greqia), si dhe fakti që disa anëtarë të Komunitetit si Anglia apo Irlanda nuk kishin vendosur akoma marrëdhënie diplomatike në Shqipëri, do dëshmonin se rruga e Shqipërisë drejtë një përgjigje pozitive për kërkesën e saj nuk do të ishte e lehtë. Më 12 korrik 1990, Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë të ashpër për Shqipërinë duke reaguar mbi ngjarjet e 2 korrikut, shkaqet dhe qëndrimin e qeverisë shqiptare. Në rezolutë, Parlamenti Evropian i kërkonte autoriteteve shqiptare *“..që të jepnin sa më parë pëlqimin e tyre për vendosjen e një demokracie pluraliste me qëllim që të favorizohen reformat ekonomike tashme të propozuara”*, si dhe ftoheshin *“..ministrat e jashtëm të mbledhur në kuadrin e bashkëpunimit politik evropian për të bërë ç’është e mundur pranë qeverisë shqiptare në mënyrë që ajo të anagazhohet në zgjidhjen paqësore të krizës së tanishme..”*.

Në takimin e 17 korrikut 1990 të MPJ-ve të TPE-së u diskutua gjendja në Shqipëri dhe kërkesa e saj për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Mbledhja vendosi dërgimin në Shqipëri të përfaqësuesve të Komisionit Politik.

Pasi qeveria shqiptare u deklarua për pranimin e dokumenteve të KSBE-së dhe angazhimin e saj për zbatimin e tyre, më 20 shtator 1990 mbërrin në Tiranë për një vizitë disaorëshe delegacioni i Trojkes së TPE. Në përfundim të vizitës, pasi vunë në dukje ndryshimet që po ndërmerreshin në demokratizimin e jetës në vend dhe hapjen e Shqipërisë me Perëndimin, theksuan se ngjarjet e korrikut 1990 tregonin se këto ndryshime nuk ishin të mjaftueshme, dhe se duhej një progres më i shpejtë në demokratizimin e jetës së vendit. Përfaqësuesit e KEE ftuan ekspertë nga Shqipëria të vizitonin Brukselin për të diskutuar për mundësitë e zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike, financiare e tregtare. U shprehën se vendosja e marrëdhënieve diplomatike nuk ishte një “çështje formale”, por do lidhej me aspektet politike dhe kërkesat aktuale të procesit të Helsinkit.

Italia kishte kryesinë e Këshillit të Ministrave të Komunitetit për periudhën korrik-dhjetor 1990. Më 11-17 dhjetor 1990, viziton Shqipërinë eurodeputeti italian Aleksandër Langer, anëtar i Komisionit të Punëve Politike të Parlamentit Evropian. Vizita kishte për qëllim njohjen e gjendjes politike në vend, proceset demokratizuese, të ardhmen e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, si dhe ndryshimet në strukturën ekonomike në Shqipëri. Ai u shoqërua nga znj. Martine Chariot-Schneider, administratore e përgjithshme e çështjeve politike dhe institucionale të Parlamentit Evropian dhe studiuesi Michele Colofato. Agjenda e tyre e takimeve ishte shumë e gjërë, në Tiranë dhe qytetet kryesore të vendit, me përfaqësues të shtetit, por edhe me komisionin nismëtar për krijimin e Partisë Demokratike,

me përfaqësues të klerit, studentë e punëtorë. Në përfundim të vizitës Langer u shpreh me optimizëm për miratimin e një rezolute pozitive për Shqipërinë në dy muajt e ardhshëm nga Parlamenti Evropian, në mbështetje të proceseve demokratizuese të pakthyeshme në të cilat kishte hyrë Shqipëria. Kjo rezolutë do t'i hapte rrugë edhe vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me KEE. Langer këmbënguli tek pluralizmi i shtypit dhe medias, të cilat duhej të trajtonin njësoj të gjithë subjektet politike në vend.

Në fakt, Komisioni Politik i Parlamentit Evropian hartoi dhe paraqiti për miratim në Parlamentin Evropian projektrezolutën për Shqipërinë dhe marrëdhëniet e saj me Komunitetin Evropian, më shpejtë se ishte e parashikuar, më 15 janar 1991. Më 21 shkurt 1991, Parlamenti Evropian miratoi projektrezolutën e paraqitur.

Në rezolutë përmendej që Parlamenti Evropian njihnte origjinalitetin e pozitës së Shqipërisë në planin politik dhe diplomatik, duke parashikuar eventualitetin e një evolucioni në Shqipëri. Ajo vazhdonte se “...*I bindur se zhvillimi i këtyre marrëdhënieve (KEE-Shqipëri) në një rajon veçanërisht të ndjeshëm dhe që paraqet një interes direkt për Komunitetin, do të jetë në të mirë të dy palëve dhe kontribuon për stabilizimin e situatës në këte rajon të Ballkanit.*”, Parlamenti vlerësoi se ishin krijuar kushtet e nevojshme për përmirësimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare midis KEE dhe Shqipërisë. Komisioni Politik ftoi qeveritë e vendeve pjesëmarrëse në KSBE të pranonin kerkesën e Shqipërisë për aderim në Konferencë.

Më 20 shkurt 1991, Ministri i Punëve të Jashtme i dërgon një notë tjetër verbale Kryetarit të Komisionit të Komunitetit Evropian, Jacques Delors, ku paraqet edhe njëherë dëshirën e Shqipërisë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Ndërkohë, në mars 1991 u zhvilluan edhe zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri.



Më 20 qershor, një ditë pas përgjigjes pozitive që dha KSBE, Drejtorja e Përgjithshme e Marrëdhënieve me Jashtë e Komisionit të Komunitetit Evropian njoftoi Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë se *“..Komisioni dhe Këshilli i Komunitetit Evropian i kishin dhënë një zgjidhje të favorshme kërkesës së qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Komunitetin Evropian..”*. 20 qershori u shpall si data e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me

KEE. Tashmë ishte hapur rruga për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me TPE dhe konkretizimin e zbatimit e tyre.

12. Angazhimi i Shqipërisë në nismat rajonale.

Proceset që po ndodhnin në Evropë në fund të viteve '80-të të shek.XX, po kuptoheshin si nevojë urgjente për të reflektuar mbi format e bashkëpunimit në Ballkan, Adriatik e më gjërë në kontinent. Në kuadër të interesave politike të Tiranës zyrtare për të hyrë në marrëdhënie me TPE e për t'u anëtarësuar në KSBE, qeveria shqiptare e tejkaloi qëndrimin e saj tradicional e tipik për Luftën e Ftohtë se *“pa marrëdhënie të mira dypalëshe nuk mund të ketë marrëdhënie të suksesshme shumëpalëshe”*, duke deklaruar se *“..bashkëpunimi në nivel rajonal nuk përjashton, por pasuron kooperimin në nivel dypalësh midis vendeve të Adriatikut”*.

Në vitin 1989 me iniciativën e qeverisë italiane, Shqipëria u thërrit si vëzhguese në takimet ku po diskutohej **“Nisma e Adriatikut”**, e cila e kishte zanafillën në marrëveshjen dypalëshe italo-jugosllave të vitit 1974. Më 17 shtator 1989, Ministrat e Jashtëm të Italisë dhe Jugosllavisë nënshkruan Deklaratën e Qëllimeve për **“Nismën e Adriatikut”**, nëpërmjet të cilës ranë dakort të bashkëpunonin në fushat e ekologjisë në Adriatik dhe në fusha të tjera të karakterit ekonomik. Ata lanë hapur që në fillim mundësinë e pjesëmarrjes së Shqipërisë dhe bashkëpunimin e shteteve që kishin dalje dhe interesa në pellgun e Adriatikut. Në takimin e 3-6 tetorit të vitit 1989

të palëve kontraktuese të Konventës së Barcelonës, (OKB 1976), dhe Planit të Veprimit të Mesdheut (PAM) të formuar për zbatimin e protokolleve të kësaj Konvente, u rekomandua që “Nisma e Adriatikut” të inkuadrohej në kuadrin e PAM.

Pas këtij zhvillimi të ri, me këmbënguljen e qeverisë italiane, me 2 nëntor 1989 pala italiane dhe ajo jugosllave u njoftuan zyrtarisht nga Tirana zyrtare për pjesëmarrjen e Shqipërisë në këtë nismë. Të njëjtën gjë bëri me pas edhe Greqia. Roma zyrtare përfshiu Shqipërinë në angazhimin e saj të parë rajonal, duke kapërcyer dallimet politike mes anëtarëve të nismës. Shqipëria mori pjesë në të gjitha takimet konsultative për këtë nismë. Kjo ishte një përpjekje e Italisë për ta mbajtur Shqipërinë pranë Perëndimit në këtë erë ndryshimesh në Evropë, e për të krijuar në Adriatik e Mesdhe një zonë të sigurt.

Më 9 janar 1990 me ftesë të MPJ italiane u organizua në Romë një takim konsultativ në nivel ambasadorësh të vendeve që lageshin nga Adriatiku. Mbledhjen e drejtoi zëvendësministri i jashtëm Italian, Ivo Butini dhe ishte ftuar edhe përfaqësuesi i Tregut të Përbashkët Evropian (TPE) për ekologjinë. Ky i fundit, kërkoi që TPE të ishte palë nënshkruese e deklaratës, pra të ishin pesë nënshkrues e jo katër. Në këtë moment shtrohej pyetja nëse Shqipëria do e pranonte këtë kërkesë të TPE, përsa kohë nuk kishte marrëdhënie diplomatike me këtë organizëm. Tirana zyrtare nuk e kundërshtoi pjesëmarrjen e TPE si palë në Nismë. Në këndvështrimin e diplomacisë shqiptare ky veprim do të shërbente si një hap pozitiv në procesin drejt vendosjes së marrëdhënieve diplomatike

me TPE. Një takim midis vendeve që do nënshkruanin deklaratën dhe përfaqësuesit të TPE, u organizua edhe në Tiranë, më 12 prill 1990. Në këtë takim pala shqiptare u shpreh dakort për zgjerimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat e mundshme, madje mendonin se bashkëpunimi ekonomik do t'i jepte një intensitet të ri marrëdhënieve midis palëve dhe Komunitetit Evropian.

Pasi u dakordësua edhe me Komisionin e Komunitetit Evropian, Deklarata e Nismës së Adriatikut u nënshkrua nga Ministrat e Punëve të Jashtme të katër vendeve, Itali, Jugosllavi, Shqipëri e Greqi, dhe përfaqësuesi i TPE në Ankona më 13 korrik 1991, pra pak ditë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me TPE, në 20 qershor 1991.

Shqipëria është anëtare në **Nismën e Evropës Qendrore (NEQ)**, ndër më të vjetrat nga nismat rajonale që filluan të vepronin në rajon, e konkretizuar në Budapest më 11 nëntor 1989 në takimin e ministrave të jashtëm të Italisë, Austrisë, Jugosllavisë dhe Hungarisë. Duke e konsideruar NEQ si një element të grupimeve integruese evropiane, në qershor 1996 Shqipëria arriti të sigurojë anëtarësinë e saj në këtë nismë. Si një vend anëtar i NEQ, Shqipëria i kushton vëmendje të veçantë bashkëpunimit në kuadrin e nismës në fusha të tilla si lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikut të paligjshëm të drogës, transport, tregti, energji, turizëm, infrastrukturë, kulturë etj.

Në qershor 1997, Shqipëria nënshkroi Instrumentin e NEQ mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve, duke

shprehur angazhimin e saj në trajtimin e barabartë të pakicave kombëtare.

Shqipëria është anëtare e **Nismës së Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SECI)**, si një grupim i vendeve të rajonit të Evropës Juglindore të cilat synojnë sigurimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë nëpërmjet bashkëpunimit. Shqipëria ratifikoi e para Marrëveshjen për bashkëpunimin, parandalimin, dhe luftën kundër krimit ndërkufitar, dhe në shtator të vitit 2000 në Shqipëri u vendos Qendra e SECI-it kundër krimit.

Shqipëria është shtet bashkëthemelues i **Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ)**, të krijuar më 25 qershor 1992 në Stamboll, me nënshkrimin e Deklaratës së Samitit të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të 11 vendeve themeluese. Shtetet u angazhuan të zhvillonin projekte të përbashkëta që të nxisnin kushtet për zhvillimin e shpejtë ekonomik dhe zgjidhje të konflikteve rajonale. Shqipëria ka qenë anëtare aktive e organizatës. Ajo ka mbajtur kryesinë e rradhës së Organizatës në periudhen maj-tetor 2008, ndërsa do të jetë përsëri në krye të kësaj organizate në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021.

Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), mbetet platforma rajonale e nivelit më të lartë politik në Evropën Juglindore, që synon bashkëpunim për paqen, sigurinë, stabilitetin, zhvillimin ekonomik, politik e shoqëror të gjithë vendeve të rajonit.

Duke e konsideruar bashkëpunimin dhe integrimin rajonal si parakusht të integritit në strukturat Euro-Atlantike, Shqipëria është anëtare e SEECP që në themelimin e saj në qershor të vitit 1996. SEECP përbëhet nga 13 vende anëtare si: Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia.

Shqipëria është një anëtare aktive e kësaj organizate rajonale dhe synon forcimin e dialogut politik, fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes rajonal, rritjes së sigurisë etj. Ajo kishte kryesinë e nismës në vitet 2014-2015. Shqipëria lloboi fort për presidencën kosovare të SEECP për periudhën korrik 2019 - korrik 2020. Gjatë kryesimit të SEECP-së, Kosova ka luajtur një rol kontribues dhe të ekuilibruar, me fokus në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe përsheptimin e procesit të integritit evropian.

Shqipëria është anëtare bashkëthemeluese e **Nismës Adriatiko-Joniane**, në maj 2000. Shqipëria ushtroi dy herë kryesimin e radhës së Nismës Adriatiko Joniane në periudhat një vjeçare, qershor 2005 – qershor 2006, dhe në qershor 2013 – maj 2014.

Në vitin 2003, Shqipëria u bë pjesë e **Inciativës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatët MARRI** – 2004. Ajo kishte kryesinë e nismës në periudhën 2017-2018. Ndërsa në shkurt të vitit 2008 Shqipëria ishte pjesë themeluese e **Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC)**. Që nga shtatori i vitit 2013 deri në fund të gushtit 2019,

përfaqësuesi i Shqipërisë ka mbajtur postin e Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm, ndersa nga janari 2019 dhe në vazhdim detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të RCC e ushtron nje perfaqesuese e Shqipërisë.

Më 28 gusht 2014 Shqipëria mori pjesë në Konferencën e nivelit të lartë të mbajtur në Berlin, e cila nisi atë që njihet tashmë si **“Procesi i Berlinit”**, ura mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, rruga për të mbajtur gjallë dialogun politik integrues të rajonit si dhe për të nxitur integrimin më të madh midis vendeve të rajonit. 6 vende anëtare të BE – Austria, Kroacia, Franca, Gjermania, Italia, Sllovenia janë anëtare të procesit bashkë me vendet e rajonit, konkretisht Shqipëria, Bosnia-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia. Nëpërmjet pjesëmarrjes në Procesin e Berlinit, Shqipëria ka fituar mundësinë e bashkëfinancimit nga BE të disa projekteve me rëndësi në ekonominë e vendit. Nga ana tjetër Shqipëria ka qenë nismëtare e dorës së parë në shkrirjen e akujve, intensifikimin e komunikimit politik midis shteteve të rajonit, për të tejkaluar ngërçet e mbartura nga e kaluara në këtë rajon, duke dëshmuar një emancipim të politikës shqiptare.

Shqipëria është shtet themelues i **Fondit të Ballkanit Perëndimor** (WBF-FBP), një organizatë ndërkombëtare e krijuar nga qeveritë e Palëve Kontraktuese të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbi. Marrëveshja për krijimin e FBP u nënshkrua nga Ministrat e Jashtëm të palëve kontraktuese, në nëntor 2015. Fondi filloi zyrtarisht veprimtarinë në 1 Tetor 2017. FBP i siguron mbështetje

financiare projekteve të vogla dhe të mëdha në fushat e edukimit, shkëmbimeve shkencore, bashkëpunimit kulturor, bashkëpunimit rinor e ndërkufitar, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Selia e FBP është në Tiranë dhe Drejtori i parë Ekzekutiv vjen nga Shqipëria.

Si vendi pritës i FBP, Shqipëria është e angazhuar që kjo organizatë e rëndësishme rajonale të konsolidohet si një mekanizëm me ndikim në ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, besimin e ndërsjellë, si dhe në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në të gjithë rajonin. Hyrja në fuqi e marrëveshjes së vendit pritës midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me Fondin e Ballkanit Perëndimor, në vitin 2017, është shembulli më i mirë i një kontributi real që Shqipëria vazhdimisht ofron në nivel rajonal.

Shqipëria mbështeti kandidaturën e Kosovës për kryesimin e Presidencës së FBP, të cilën arriti ta finalizonte në vitin 2019. Presidenca kosovare u fokusua në forcimin dhe rritjen e mëtejme të bashkëpunimit rajonal.

Shqipëria është pjesë e marrëveshjes për themelimin e **Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)**, të nënshkruar më 4 korrik 2016, në Paris, nga Kryeministrat e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Selia e RYCO u vendos të jetë në Tiranë, ndërsa organizata filloi punën më 4 prill 2017. Krijimi i saj ishte rezultat i vullnetit të përbashkët politik të qeverive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe i ndihmës së çmuar të partnerëve evropianë, si Franca dhe Gjermania. Kujdesi i

tyre dhe mbështetja financiare kanë qenë të dobishëm për suksesin e RYCO-s.

Në kuadër të punës së RYCO, Shqipëria mbështet projekte që kontribuojnë në pajtimin dhe krijimin e besimit në rajon përmes rritjes së mobilitetit të rinisë, bashkëpunimit dhe ndërveprimit, me qëllim shkëmbimin e vlerave më të mira të rinisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në 2019 Kosova kryesoi Presidencën e RYCO-s. Gjatë presidencës kosovare, RYCO hapi zyra lokale në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

RYCO konsiderohet si arritja më e madhe e Procesit të Berlinit, si një organizëm që ka filluar të japë kontribut të prekshëm në drejtim të afrimit të të rinjve të Ballkanit Perëndimor.

13. Anëtarësimi i Shqipërisë në Këshillin e Evropës, 13 korrik 1995.

Këshilli i Evropës, organizata më e vjetër politike në Evropë, me fokus forcimin e identitetit kulturor evropian, demokracive pluraliste dhe të drejtave të njeriut, ngjalli shumë interes për vendet e Evropës Lindore që po dilnin nga orbita sovjetike dhe po rrezonin rregjimet komuniste në fund të viteve '80-të. Edhe Shqipërisë i ishin bërë ftesa zyrtare të herë pas hershme për të marrë pjesë në aktivitetet e Këshillit të Evropës, por që ishin refuzuar nga qeveria shqiptare për shkaqe politike e ideologjike të kohës.

Pas vizites së Sekretarit të Përgjithshem të OKB-së De Kuellar në Shqipëri në maj 1990, ngjarjeve të korrikut të vitit 1990, dhe në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në KSBE, në shtator të vitit 1990, dy deputetë të Kuvendit të Shqipërisë morën pjesë në debatin mbi bashkëpunimin dhe sigurimin në Evropë, organizuar nga Asambleja e Këshillit të Evropës. Në kuadër të këtij interesimi të ri të Shqipërisë për aktivitetet e bashkëpunimit parlamentar gjithë evropian, në shkurt 1991 Kryetari i Asamblesë Parlamentare të KiE, Andres Bjorck, i dërgon një letër Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë ku e njofton që për të vazhduar këtë bashkëpunim Asambleja Parlamentare e KiE duhej të ndiqte zgjedhjet legislative në shtetet joanëtare të KiE, praktikë e ndjekur edhe me vendet e tjera të Lindjes. Kjo i sugjerohej edhe Shqipërisë për zgjedhjet e 31 marsit 1991. Ky sugjerim u pranua nga qeveria shqiptare dhe këto zgjedhje u ndoqën nga një delegacion vëzhguesish nga Asambleja Parlamentare e KiE. Në prill 1991 Komiteti i Ministrave të KiE diskutoi çështjen e marrëdhënieve me Shqipërinë mbi bazën e konkluzioneve të delegacionit dhe kërkoi avancimin e reformave në Shqipëri për demokratizimin e plotë të Shqipërisë dhe respektimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Në 23 maj 1991 viziton Shqipërinë Catherine Lalumiere, Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Evropës e shoqëruar nga Presidenti i Komitetit të Ministrave të KiE Steve Andersson. Kjo vizitë shënoi fillimin e dialogut të drejtëpërdrejtë me Organizatën.

Pas anëtarësimit me të drejta të plota në KSBE, në shtator 1991 Shqipërisë iu dha statusi i “anëtarit shok” pranë Komisionit të Këshillit të Evropës “Demokracia nëpërmjet ligjit”, dhe në 25 nëntor 1991 Shqipëria mori statusin “special guest” në KiE. Shqipëria dorëzoi aplikimin për anëtarësim në organizatë në 4 maj 1992.

Një vit më pas, me 6 dhjetor 1993 qeveria shqiptare miratoi hapjen e Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Këshillit të Evropës.

Me 27 prill 1995 Asambleja Parlamentare e KiE dorëzoi opinionin pozitiv 189(1995) mbi pranimin e aplikimit për anëtarësim të Shqipërisë. Dy muaj më pas, Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Alfred Serreqi, firmosi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare. Më 13 korrik 1995, Shqipëria u anëtarësua në Këshillin e Evropës si anëtare me të drejta të plota.



Shqipëria mori Kryesinë e parë të Komitetit të Ministrave të KiE më 23 maj - 9 nëntor 2012. Prioriteti kryesor i kësaj Kryesie ishte promovimi i shoqërive demokratike të qëndrueshme.

14. Pranimi i Shqipërisë në NACC (Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut) (qershor 1992) dhe anëtarësimi i saj në NATO (4 prill 2009).

Pas daljes ‘de jure’ nga Traktati i Varshavës, në vitin 1968, një aleancë ushtarake e bllokut të lindjes, Shqipëria nuk bëri pjesë në asnjë aleancë ushtarake gjatë pjesës së mbetur të Luftës së Ftohtë. Ajo e shikonte me frikë dhe me frymë armiqësore NATO-n, si aleancë ushtarake e bllokut perëndimor. Në gjysmën e dytë të viteve ‘80-të në kuadër të procesit të pashmangshëm të hapjes ndaj perëndimit, qeveria shqiptare filloi të interesohet edhe për pozicionin e NATO-s në këtë situatë të re, ndryshimet në strategjinë e saj të sigurisë dhe vendin e Shqipërisë në këtë strategji. Pas pranimin të Shqipërisë në KSBE, në qershor 1991, për Shqipërinë u krijuan mundësi të reja për të rritur interesimin ndaj saj dhe për të qenë pjesë e strategjive të sigurisë evropiane në një botë të ekspozuar ndaj rreziqeve të reja pas shkrirjes së akujve të Luftës së Ftohtë midis dy blloqeve.

Në gusht 1991, nga NATO mbërrin ftesa e parë për Shqipërinë, nëpërmjet ambasadës shqiptare në Romë, për të marrë pjesë në trajnime të specializuara për të gjitha vendet anëtare të KSBE pranë strukturave trajnuese të NATO-s në Itali e Gjermani. Duke e konsideruar këtë moment “..si një ndryshim të politikës së NATO-s ndaj

Shqipërisë”, në kushtet e ndryshimit të klimës politike në Evropë qeveria shqiptare miratoi pjesëmarrjen në këtë aktivitet të ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Romë. Si vend anëtar i KSBE-së Shqipëria mori pjesë në tetor të vitit 1991 edhe në seminarin ndërkombëtar “NATO në udhëkryq” me fokus në ristrukturimin e sigurisë evropiane, të organizuar nga Aleanca.

Në nëntor 1991, në takimin e krerëve të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të NATO-s të mbajtur në Romë, u vendos krijimi i “Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut” NACC, i cili ishte një manifestim i “dorës së miqësisë” të zgjatur në takimin e krerëve të shteteve dhe qeverive të vendeve të NATO-s, në korrik 1990 në Londër, ku udhëheqësit aleatë propozuan një marrëdhënie të re bashkëpunimi me të gjitha vendet në Evropën Qendrore dhe Lindore pas Luftës së Ftohtë. U ra dakort që aty të merrnin pjesë 16 anëtarë të NATO-s, 6 anëtarë të ish-Traktatit të Varshavës, tre shtetet balltike që sapo ishin shpallur të pavarura, si dhe u ftuan të merrnin pjesë dhe njëmbëdhjetë ish-republikat sovjetike të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (CIS) të sapoformuara. Mbledhja themeluese e tij do të mbahej më 20 dhjetor 1991 në Bruksel, ku pritej të miratohej një deklaratë politike e përbashkët për të shënuar fillimin e një epoke të re partneriteti e të institucionalizojë marrëdhëniet e këtyre vendeve me NATO-n. Jashtë këtij Këshilli mbeteshin Shqipëria dhe vendet neutrale apo të paangazhuara. Në kuadër të synimit për vendosjen e marrëdhënieve me NATO-n qeveria shqiptare filloi përpjekjet në skenën diplomatike ndërkombëtare që të

përfshihej në këtë Këshill e të merrte pjesë në mbledhjen e 20 dhjetorit për të njohur klimën e re brenda organizatës.

Përgjigja ishte negative. Në këtë takim vendet anëtare të NATO-s u shprehën se *„kemi ndjekur nga afër zhvillimet në vendet e tjera të Evropës Qendrore e Lindore. Përshëndesim progresin e vazhdueshëm në drejtim të pluralizmit politik, respektimin e të drejtave të njeriut dhe ekonominë e tregut. Inkurajojmë këto vende të vazhdojnë reformat dhe të kontribuojnë në zbatimin e mëtejme të angazhimeve të KSBE dhe marrëveshjeve për kontrollin e armëve”*. Përpjekjet u intensifikuan pas zgjedhjeve të marsit 1992. Qeveria e re demokratike hyri në kontakte me zyrtarë të lartë të NATO-s duke lobuar për situatën e re politike në Shqipëri dhe nevojën e Shqipërisë për të qenë pjesë e NACC.

Me 24 prill 1992 qeveria shqiptare iu drejtua me një letër NATO-s për pranimin e Shqipërisë në NACC në takimin e Oslos, në qershor 1992. Në takimin e 5 qershorit 1992 të NACC në Oslo, Shqipëria dhe Gjeorgjia u pranuan si anëtare të NACC, me vendim të Këshillit të Ambasadorëve të NATO-s (NAC), dhe po atë ditë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Manfred Woerner (1988 – 1994), njoftoi zyrtarisht qeverinë shqiptare për vendimin e MPJ të vendeve anëtare të NACC. Ai i kërkoi Shqipërisë të shprehte miratimin e saj për deklaratat e NACC në takimet e 20 dhjetorit 1991, 10 marsit 1992, dhe 5 qershorit 1992. Qeveria shqiptare u shpreh pozitivisht përsa kërkohet nëpërmjet letrës e 30 qershorit 1992 të kryeministrit shqiptar për Sekretarin e Përgjithshëm

Woerner. Që nga ky moment filluan përpjekjet për hapat e radhës deri në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.

Më 23 shkurt 1994, Shqipëria u anëtarësua në nismën e 'Partnership for Peace' (PFP) nëpërmjet nënshkrimit të dokumentin kuadër të PFP i cili u ratifikua më 20 prill 1994 nga parlamenti shqiptar. Në korrik 1994 Shqipëria hapi në NATO zyrën e Përfaqësuesit ushtarak në NACC. U vendos dhe një oficer koordinues në SHAPE .

Më 30 maj 1997 në takimin Ministerial në Sintra (Portugali), pavarësisht nga kushtet e vështira që po kalonte vendi, Shqipëria arriti të anëtarësohet në forumin e ri politik të NATO-s dhe vendeve partnere që zëvendesoi NACC, dhe që u quajt Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC). Në tetor 1997 u bë hapja e Misionit diplomatik të Shqipërisë në selinë e NATO-s.

Në Mars 1998, Shqipëria u bë i pari vend partner i NATO-s që përdori prerogativat e dokumenti kuadër të Partneritetit për Paqe (neni 8). Sipas këtij neni çdo vendi partner i lind e drejta të kërkojë konsultime politike me Këshillin e NATO-s për të trajtuar vetëm me vendet anëtare të NATO-s shqetësimet e tij të sigurisë.

Më 23-24 Prill 1999, Samiti jubilar i Uashingtonit krijoi një mundësi të re veprimi për anëtarësimin e Shqipërisë dhe tetë vendeve të tjera aspirantë nga Evropa qëndrore dhe Lindore të cilët u ftuan të bëhen pjesë e nismës 'Membership Action Plan' (MAP).

Në nëntor 1999, Shqipëria paraqiti në NATO dokumentin e saj të parë të Planit Kombëtar të Anëtarësimit në kuadër të ‘Membership Action Plan’ (MAP).

Në maj 2003, Shqipëria, Kroacia, Maqedonia dhe ShBA-të, nënshkruan në Tiranë “Kartën ShBA-Adriatike” e cila është një nismë sigurie ndihmëse për anëtarësimin e tre vendeve në NATO nën shembullin e “Kartës Balltike”.

Në 3 prill 2008, Shqipëria mori ftesën për t’u anëtarësuar në NATO në Samitin e Bukureshtit, pas përmbjlljes së ciklit të 9-të të Planit të Veprimit për Anëtarësimin (MAP) dhe kryerjes së një sërë reformave që synonin plotësimin e kriterëve të nevojshme për anëtarësimin në Aleancë.

Në 1 prill 2009, Shqipëria u anëtarësua në NATO pas përfundimit të ratifikimit të Protokollit të Anëtarësimin nga të gjitha vendet aleate dhe depozitimit të instrumentit të aderimit në NATO, në Departamentin e Shtetit që është edhe mbajtësi ligjor i Traktatit të Uashingtonit. Kjo datë është de jure edhe data zyrtare e anëtarësimin të vendit në NATO. Duke u bërë palë e këtij traktati dhe shtet anëtar i NATO-s, Shqipëria përmbushi një synim strategjik dhe një objektiv parësor të politikës së jashtme, duke avancuar ndjeshëm në realizimin e interesave të saj kombëtare.



Që prej anëtarësimit të saj në NATO, Shqipëria e sheh sigurinë e saj të lidhur pazgjidhshmërisht me sigurinë e territorit që mbulojnë prerogativat e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe e konsideron NATO-n si gurin e themelut të sigurisë së përbashkët të vendeve të saj anëtare. Shqipëria mbështet aktivisht unitetin e Aleancës rëndësinë thelbësore të lidhjes Transatlantike në mënyrë që NATO të mbetet kolonë stabiliteti për gjeneratat e ardhshme. Në kuadrin e përpjekjeve të Aleancës për përballimin e kërcënimeve nga Lindja dhe nga Jugu, që prej vitit 2014 dhe në përputhshmëri të plotë me konceptin aktual strategjik të NATO-s, Shqipëria është dhe do të vazhdojë të jetë plotësisht e angazhuar për të dhënë kontributin e saj në suazën e NATO-s. Ushtarakët shqiptarë shërbejnë në operacionet dhe misionet e Aleancës në Afganistan, Kosovë dhe vendet balltike. Si anëtare fillestare e Koalicionit Global kundër “Shtetit Islamik”, Shqipëria mbështet aktivisht rolin e intensifikuar të NATO-s në luftën kundër terrorizmit si dhe projektimin e stabilitetit në dhe përreth zonës euroatlantike.

15. Procesi i integritimit evropian të Shqipërisë.

Integrimi evropian i Shqipërisë ka qenë një ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme qëkurse Shqipëria vendosi marrëdhënie diplomatike me Komunitetin Evropian, më 20 qershor 1991.



Në qershor 2001, Këshilli i Ministrave të BE-së miratoi raportin e Komisionit Evropian mbi progresin e bërë nga Shqipëria dhe i kërkoi Komisionit përgatitjen e projekt-direktivës për negocimin e një Marrëveshjeje Stabilizim-Asocimi (MSA). Në këtë moment u krijua grupi konsultativ BE-Shqipëri.

Në 31 janar 2003, u çelën negociatat zyrtare për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit dhe në shkurt të vitit 2003 nisi raundi i parë i tyre.

Në prill 2005, në Luksemburg, u nënshkrua Marrëveshja e Ripranimit Shqipëri-BE. Në shkurt 2006, në Tiranë, u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Në qershor 2006, u nënshkrua Marrëveshja e Përkohshme për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, e cila hyri në fuqi në 1 dhjetor 2006.

Në 1 prill 2009, hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe në 28 prill 2009, Shqipëria paraqiti në Këshillin e BE-së kërkesën për anëtarësim. Në 16 nëntor 2009, GAERC-i (Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe i Marrëdhënieve me Jashtë) i kërkoi Komisionit të përgatisë Opinionin për Shqipërinë. Në 16 dhjetor 2009, Shqipërisë iu dorëzua pyetëtori nga Komisioni Evropian, mbi vlerësimin e gadishmërisë së Shqipërisë për të nisur negociatat e anëtarësimit në BE dhe për të përmbushur detyrimet që lindin nga ky anëtarësim. Ai përbëhej nga 2280 pyetje në 384 faqe. Në bazë të përgjigjeve të pyetësorit, të realizuara nga një angazhim intensiv i administratës shqiptare, më 10 nëntor 2010 u publikua Opinioni i Komisionit Evropian për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE bashkë me rekomandimet përkatëse.

Në raport progresin e vitit 2012, Komisioni Evropian i rekomandoi Këshillit Evropian dhënien e Statusit të Vendit Kandidat të Shqipërisë, në varësi të përmbushjes së masave kyçe në fushën e drejtësisë dhe reformës së administratës publike, si dhe përfundimin e rishikimit të procedurave të rregullores parlamentare. Në nëntor 2013 u lançua dialogu i nivelit të lartë për prioritetet kyçe

Shqipëri-Komisioni Evropian, ku marrin pjesë përfaqësues të qeverisë, institucioneve të pavarura dhe opozitës.

Marrja e statusit të vendit kandidat do të vinte pesë vjet pas paraqitjes së kërkesës zyrtare për anëtarësim, në 2014, kur Këshilli Evropian, pasi shqyrtoi raport-progresin e Komisionit për vendin tonë (4 qershor 2014), nën dritën e progresit të vazhdueshëm të Shqipërisë, vendosi të miratonte rekomandimet e Komisionit. Vendimi u zyrtarizua në Këshillin Evropian të 27 qershorit 2014.

Dhënia e statusit të vendit kandidat ishte një ngjarje e shënuar dhe një hap përpara në realizimin e aspiratës evropiane të Shqipërisë, të cilës i përkiste jo vetëm gjeografikisht dhe historikisht, por edhe shpirtërisht gjithashtu.

Hapi pasardhës tashmë ishte hapja e bisedimeve/negociatave të anëtarësimit. Në nëntor 2016, Komisioni Evropian publikon Raportin për Shqipërinë për vitin 2016 dhe rekomandon për herë të parë nisjen e negociatave të anëtarësimit. Që nga shtatori 2017 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është institucioni kryesor shtetëror në qeverinë shqiptare që drejton dhe koordinon procesin e integritit evropian. Në prill të vitit 2018, Komisioni rekomandoi për herë të dytë hapjen pa kushte të negociatave për anëtarësim. Këtë e përsëriti në 29 maj 2019 e në 2 mars 2020, bazuar në progresin e bërë nga Shqipëria.

Në 26 mars 2020 vendet anëtare të BE-së, Këshilli Evropian, duke vlerësuar reformat e ndërmarra në Shqipëri për shtetin e së drejtës e forcimin e demokracisë në vend, arritën një marrëveshje politike për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë, duke hapur një faqe të re në rrugën e saj evropiane.

Rregjimi pa viza me BE

Në mars 2008, u lançua dialogu për Liberalizimin e Vizave mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Udhërrëfyti për Shqipërinë u dorëzua zyrtarisht në qershor 2008, për të vijuar me procesin e përbushjes së kritereve të përcaktuara në këtë dokument nga vendi ynë. Në bazë të plotësimit të kritereve të Udhërrëfyesit, në 15 shtator 2010, Komisioni Evropian hartoi një vlerësim pozitiv për Shqipërinë, për Parlamentin Evropian dhe vendet anëtare të BE-së. Ky vlerësim i hapi rrugën vendim-marrjes për liberalizimin e vizave për qytetarët shqiptarë drejt hapësirës “Schengen”. Këshilli i Çështjeve të Brendshme të BE-së miratoi unanimitisht propozimin e Komisionit dhe në datën 15 dhjetor 2010, hyri në fuqi regjimi pa viza i lëvizjes së qytetarëve shqiptarë drejt hapësirës “Schengen”.

16.Shqipëria merr Kryesinë e OSBE-së 2020

Pas aplikimit për të marrë kryesimin e OSBE-së në vitin 2012 dhe më pas në vitin 2014, në gusht të vitit 2018 Shqipëria paraqiti përsëri kandidaturën e saj për marrjen e kryesimit të organizatës për vitin 2020. Ky vendim u mbështet në progresin e shënuar në respektimin e parimeve dhe vlerave të OSBE-së që prej anëtarësimit në këtë organizatë në 19 qershor 1991. Në të njëjtën kohë, kandidatura shqiptare ishte reflektim i rritjes së profilit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, rolit aktiv të saj në forumet shumëpalëshe, qëndrimeve të saj konstruktive në rajon, si dhe kontributeve që Shqipëria ka dhënë në fushën e sigurisë në adresimin e sfidave aktuale.

Vendimi për kandidaturën e Shqipërisë u mor gjatë Takimit të 25-të të Këshillit Ministror të OSBE-së, mbajtur me 6-7 dhjetor 2018 në Milano, nën kryesinë italiane të OSBE-së për vitin 2018. Në këtë takim, kandidatura e Shqipërisë për të drejtuar OSBE-në në vitin 2020 u mbështet unanimisht nga të gjitha vendet anëtare të Organizatës. Angazhimet e Shqipërisë si kryesuese e OSBE-së në 2020 nisen që në 1 janar 2019, kur Shqipëria do të ishte pjesë e Trojkës së OSBE-së bashkë me Italinë, që pati kryesinë përgjatë 2018 dhe me Sllovakinë, si kryesuese përgjatë 2019.



Gjithashtu, Shqipëria kryesoi Grupin e Kontaktit të Mesdheut në vitin 2019, duke organizuar disa aktivitete që kulmoi me mbajtjen e Konferencës vjetore Mesdhetare në Tiranë, në datat 24-25 tetor 2019.

Vendimi për t'i besuar Shqipërisë drejtimin e OSBE-së në vitin 2020 shënon një arritje të rëndësishme në politikën e jashtme të Shqipërisë në kuadër të organizatave ndërkombëtare dhe bashkëpunimit shumëpalësh. Tashmë, Shqipëria kalon në fazën e kontributit për arkitekturën e sigurisë evropiane duke qenë në drejtim të një organizate shumë-dimensionale si OSBE, ku spikat dimensionin mesdhetar, euroatlantik dhe euroaziatik. Duke marrë kryesinë, Shqipëria shpreh angazhimin e saj për të punuar për forcimin e paqes, sigurisë dhe prosperitetit në hapësirën e OSBE-së.

Punoi:

Prof.Asoc.Pranvera Teli (Dibra),
Drejtoreshë e Drejtorisë së Arkivit Historik në Ministrinë për
Evropën dhe Punët e Jashtme.

Bashkëpunuan në temat 4,12,14,15,16:

Drejtoresha e Organizatave Ndërkombëtare;
Drejtoresha e Rajonit dhe e Vendeve Fqinje;
Drejtoresha e NATO-s;
Drejtoresha e BE-së;
Task-Forca e Kryesisë së OSBE-së;